



24 shtator 2010, Prishtinë

VENDIM I KËSHILLIT TË KPM-SË PËR PERCAKTIMIN E AFATIT PËRFUNDIMTAR PËR INSTALIMIN E FILTRIT

Në pajtim me nenin 11.3 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim (**Ligji Nr. 02/L-15**), KPM ka përmbyllur procesin e licencimit afatgjatë. Megjithatë, ka mbetur një numër i vogël i subjekteve transmetuese të cilat nuk kanë arritur të instalojnë filtrin dalës si një prej kushteve kryesore teknike për licencimin afatgjatë.


Këshilli i KPM-së, ka marrë një vendim që licencat e përkohshme të lëshuara nga Komisioneri i Përkohshëm për Media, të konsiderohen të vlefshme deri më 30 qershor 2010. Edhe pas këtij afati, subjektet transmetuese të paraqitura si me poshtë, nuk kanë arritur të instalojnë filtrin dalës për arsye të ndryshme:

1. RADIO BUBAMARA
2. RADIO EVROPA
3. RADIO KOSOVSKA MITROVICA
4. RADIO AS DB
5. URBAN FM

Sidoqoftë, Këshilli i KPM-së ka vendosur që të ofron mundësinë e fundit këtyre subjekteve transmetuese që të ndërmarrin hapat e duhur për të përmbyllur standardet teknike, duke instaluar filtrin dalës në një afat **prej 30 ditësh** nga data e pranimit të këtij vendimi. Në këtë mënyrë, subjektet transmetuese të paraqitura më lartë mund të pajisen me licencë afatgjate dhe të vazhdojnë ligjërisht veprimtarinë e tyre transmetuese.

Në të kundërtën, Këshilli i KPM-së është zotuar se pas afatit të përcaktuar me këtë vendim, do të ndërmerr të gjitha masat e duhura ligjore për të ndërprerë transmetimin ilegal për të gjitha subjektet transmetuese të cilat nuk arrijnë të pajisen me licencë afatgjate të KPM-së.


Filloreta Bytyqi
Kryesuese e Këshillit të KPM-së



KOMISIONI I PAVARUR PËR MEDIA

Ref:1009/1149/KKPM/ni